

Artur Gaxha



GJYQATAR PRANË GJYKATËS SË
APELIT TIRANË


Deklaratat e analizuara:

15 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri
Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017

Ndryshimi i Pasurisë ndër Vite




Pasuria bruto është rritur 19.5 herë.

+ 6,709,243 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.


Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete
në Bankë




Likuiditete
në Cash




Pasuritë e
Luajtshme



Pasuritë e
Paluajtshme



Pjesë në
Kapital



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga funksioni	15,109,623	13.03%
Të ardhura nga paga e familjarëve	25,434,644	21.94%
Të ardhura nga Qira	3,414,335	2.95%
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	1,027,190	0.89%
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	67,792,483	58.48%
Të ardhura të tjera	3,138,096	2.71%
Total	115,916,371	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

4 deklarata Me Probleme
10 deklarata Pa Probleme

Subjekti Artur Gaxha rezultoi me burime të pamjaftueshme financiare gjatë 4 viteve të ndryshme, (pa llogaritur në këtë analizë minimumin jetik të shpenzimeve për jetesë) si më poshtë:

Në vitin 2004 subjekti deklaroi shtesa dy automjete në vlerë totale 12,500 euro, por burimet financiare nuk justifikojnë shtesën për vlerë -9,683 lekë.

Në vitin 2005 subjekti deklaroi shtesa aset pasuri e paluajtshme në vlera 134,150 USD dhe 26,000 euro, pa shpjeguar asnjë burim të ardhurash për këto shtesa duke rezultuar me diferencë negative në vlerën -15,544,681 lekë.

Në vitin 2011 subjekti rezultoi me burime financiare të pamjaftueshme në vlerë -2,723,924 lekë. Gjatë vitit subjekti shet aset pasuri të paluajtshme në vlerë 120,000 euro, shumë të cilën e depoziton në llogari bankare. Shtoi aset automjetet në vlerë 55,000 USD, për të cilin nuk specifikoi burim të ardhurash. Dhe shlyen total detyrim ekzistues 120,000 ndaj shoqërisë së ndërtimit, nëpërmjet një kredie të re të marre me të njëjtën shumë.

Në vitin 2014 deklaroi shtesa pasuri të paluajtshme vlerë 5,325,000 lekë, shtesa depozita bankare 184,000 euro dhe shlyerje totale kredie bankare në vlerë 175,250 euro, pa shpjeguar asnjë burim të ardhurash për këto shtesa, duke rezultuar me burime financiare të pamjaftueshme në vlerë -52,266,253 lekë.

Në vitin 2013, bashkëshortja e subjektit deklaroi apartament banimi përfituar me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, me burim financiar kredi bankare nga Tirana Bank (viti 2008). Ky apartament është shitur brenda vitit në shumën 450,000 euro - mungon çmimi i blerjes së këtij apartamenti. Nga kredia bankare në emër të shoqërisë (nuk sqarohet as emri i shoqërisë dhe as lidhja e bashkëshortes së subjektit me të) Jka mbetur detyrim i pashlyer shuma 175,250 euro, që ndahet mes 2 ortakëve.

Në vitin 2010 subjekti deklaroi huamarrje nga motra 15,000 USD, por në deklaratim në vazhdim nuk jep shlyerje të tij.

Detyrime ndaj shoqërisë së ndërtimit viti 2007 në vlerë 16,000 euro, gjatë deklaratimeve rezultoi shlyerje vetëm për 11,000 euro.

Kreditë bankare janë të pranishme si burim financimi: (i) viti 2006 vlerë 1,500,000 lekë -shlyer regullisht shuma totale gjatë viteve; (ii)viti 2011 vlerë 120,000 euro - vazhdon shlyerja regullisht gjatë viteve dhe; (iii)viti 2013 shuma 175,250 euro - shlyer plotësisht në vitin 2014.